



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR KOMPANITË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT NË KOSOVË - 2022



Shtator,
2023

MISIONI

“Rregullim i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik”

VIZIONI

“Shërbime cilësore, të sigurt dhe eficientë të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

PËRMBAJTTJA

1.	HYRJE.....	5
2.	PERFORMANCA E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE.....	7
2.1	PERFORMANCA OPERATIVE - FURNIZIMI ME UJË.....	7
2.1.1	<i>Cilësia e Ujit.....</i>	7
2.1.2	<i>Mbulueshmëria me shërbime të ujësjetës.....</i>	8
2.1.3	<i>Matja e ujit</i>	9
2.1.4	<i>Ankesat</i>	10
2.1.5	<i>Konsumatorët e prekur nga presioni i ultë</i>	11
2.1.6	<i>Vazhdimësia e furnizimit me ujë</i>	12
2.1.7	<i>Plasuritja e gypave në rrjetin e ujësjetës</i>	14
2.2	PERFORMANCA FINANCIARE-FURNIZIMI ME UJË	16
2.2.1	<i>Vlera monetare e shitjeve</i>	16
2.2.2	<i>Shpenzimet kapitale për ujësjetës</i>	18
2.3	PERFORMANCA OPERATIVE-SHËRBIMI I UJËRAVE TË NDOTURA	21
2.3.1	<i>Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara.....</i>	21
2.3.2	<i>Shpeshësia e bllokimit të rrjetit të kanalizimit.....</i>	21
2.3.3	<i>Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizim)</i>	22
2.3.4	<i>Ankesat</i>	23
2.4	PERFORMANCA FINANCIARE-SHERBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA	24
2.4.1	<i>Vlera e planifikuar e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura (Euro)</i>	24
2.4.2	<i>Vlera e realizuar e shitjeve të shërbimit të ujërave të ndotura (Euro)</i>	24
2.4.3	<i>Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura</i>	25
2.4.4	<i>Kostoja totale për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura të realizuara në raport me atë të planifikuar</i>	25
2.4.5	<i>Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura</i>	26
2.5	PERFORMANCA E PËRGJITHSHME FINANCIARE E KRU.....	29
2.5.1	<i>Arkëtimi i të ardhurave KORIGJIMI në varsi nga inspektimi KRU GJAKOVA.....</i>	29
2.5.2	<i>Kthimi në kapital</i>	30
2.5.3	<i>Shpenzimet operative.....</i>	31
2.5.4	<i>Efikasiteti i stafit.....</i>	34
3.	PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË.....	36
	SHTOJCA 1:Pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave.....	37
	SHTOJCA 2: PASQYRAT TARIFORE (2021-2022).....	40

Akronimet dhe shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
BPRR	Biznes Planet Rregullatore
BRRR	Baza Rregullatore e Aseteve
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
KNMU	Këshillit Ndërmintor për Ujëra
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjetës
NJPM-NP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
QU	Qendra e Ujit
UPF	Uji i Pa-Faturuar
UA	Udhëzimi Administrativ
UKRR	Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator
O.SH	Ofruesit e Shërbimeve
SIG	Sistemi Informativ Gjeografik
TKP	Treguesit Kyç të Performancës
PR	KRU ‘Prishtina’, Prishtinë
PZ	KRU ‘‘Hidroregjioni Jugor’’, Prizren
PE	KRU ‘‘Hidrodrini’’, Pejë
MIT	KRU ‘‘Mitrovica’’, Mitrovicë
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
GJA	KRU ‘‘Gjakova’’, Gjakovë
FE	KRU ‘‘Bifurkacioni’’, Ferizaj
GJI	KRU ‘‘Hidromorava’’, Gjilan

1. HYRJE

Një nga përgjegjësitë funksionale të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është edhe monitorimi dhe raportimi mbi performancën e ofruesve të shërbimeve të ujit të pijshëm dhe trajtimit të ujërave të ndotura, në përgjithësi dhe në mënyrë specifike kundrejt objektivave të performancës dhe efikasitetit që kemi vendosur në kuadër të proceseve rregullatore. Në këtë mënyrë ARRU, siguron që konsumatorët të marrin shërbime me vlerë për para dhe cilësi të shërbimeve të garantuara me kuadrin ligjor.

Raporti paraqet një analizë të detajuar mbi gjendjen dhe nivelin e shërbimeve të ujit në vend dhe vlerëson performancën operative dhe financiare të shtatë (7) Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (KRU) dhe të Ndërmarrjes Hidro-Ekonomike (NHE) Ibër Lepenci. Analizat e paraqitura në këtë raport janë bazuar në të dhënat e raportuara nga ofruesit e shërbimeve të ujit, të cilat janë verifikuar nga ana e ARRU-së.

Raporti i hartuar për më tepër është edhe një instrument informimi për publikun dhe të gjithë akterët e përfshirë në sektorin e ujit.

Vlerësimi i performancës së KRU-së, për vitin raportues 2022, tregon se këto kompani vazhdojnë të ofrojnë një nivel relativisht të kënaqshëm sa i përket cilësisë së shërbimeve të ofruar konsumatorëve, por nuk performojnë mirë kundrejt objektivave të tyre të efikasitetit financiar dhe operativ. Eficienca operative dhe komerciale e KRU-ve, është ende shumë më e ulët, se sa që ajo do të duhej të ishte, në veçanti në performancën shitjeve dhe arkëtimit të të ardhurave. KRU pësojnë nga keqpërdorimi i ujit si dhe mos pagesa për shërbimet e ofruara për konsumatorë, ne besojmë që KRU mund/duhet të bëjnë edhe më shumë për të arkëtuar këtë burim të të ardhurave, p.sh. përmes aplikimit të politikave të vendosura por të drejta të shkyçjeve, ne po ashtu besojmë se edhe vetë konsumatorët mund dhe do të duhet të jenë më mbështetës.

Me keqardhje konstatojmë se kompanitë nuk kanë arritur ti përmbushin objektivat e planifikuara me ARRU, në disa prej treguesve kyç financiar siç janë: shitjet e ujit, arkëtimin e keshit, shpenzimet operative dhe ato kapitale. Nga ana tjetër gjatë këtij vlerësimi vjetor në krahasim me vitin paraprak, kemi identifikuar edhe trende pozitive në këto treguesit e përmbushjes së standardeve të shërbimit.

Treguesit e përmbushjes së standardeve të shërbimit kryesisht janë të qëndrueshëm, shumica e KRU kanë arritur të kenë furnizim të qëndrueshëm, raporti i matjes është përmirësuar nga 98% në 2021 në 99% në 2022, kjo do të thotë se vetëm 1% e konsumatorëve shtëpiak faturohen pa ujëmatës, po ashtu është përmirësuar edhe efikasiteti i stafit. Megjithatë të gjitha KRU-të, ende përballen me disa sfida të përbashkëta si: norma e madhe e humbjeve të ujit në rrjetet e shpërndarjes dhe keqpërdorimeve, cilësi e dobët e ujëmatësive, rrjete të dobëta të ujësjellësit dhe të papërshtatshme të kanalizimeve dhe mungesë e sistemet e trajtimit të ujërave të ndotura, disa prej tyre kanë furnizimin me ndërprerje dhe dështime në cilësinë e ujit në rubinet e konsumatorit.

Në Kosovë, zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për zgjerimin e rrjetit të kanalizimit dhe trajtimit i duhur i ujërave të ndotura mbetet po ashtu sfida kryesore për mjedisin. Kujtojmë se infrastruktura e kanalizimit nuk është ende e kënaqshme, ende 35% e popullsisë nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimit. Nga 156.8 mil.m³, ujë i distribuuar në sistemin e ujësjellësit këtë vit nga KRU-ja, rreth 75 % e sajë është shkarkuar i pa trajtuar në lumenj, duke rrezikuar në masë të madhe mjedisin dhe shëndetin e popullatës.

KRU, kanë qenë në gjendje që nga rrjedhja e parasë të sigurojnë të hyra të mjaftueshme për mbulimin e kostove operative (përfashtuar KRU 'Mitrovica'), me një suficit të vogël për të realizuar investime të kufizuara kapitale në rrjetin shpërndarës të ujit dhe ujërave të ndotura. Pra gjatë kësaj

periudhe KRU-të nuk kanë treguar performancë të kënaqshme/të pritshme në efikasitetin operativ dhe komercial / financiar.

Si do që të jetë informacionet e prezantuara në këtë raport janë në interes të konsumatorëve, menaxherëve të KRU-së, investitorëve, Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, të dinë se si po performojnë ofruesit e shërbimeve dhe sektori i ujit në përgjithësi.

Së fundi dëshirojmë të falënderojmë stafin e KRU-ve, për kontributin në raportimin e të dhënave, si dhe stafin e ARRU për përpilimin e këtij raporti dhe angazhimin në punën e përditshme të tyre.

Shënim:

Në Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2022, ARRU ka vendosur të mos i publikojë disa nga treguesit standard të performancës, për shkak të ndryshimeve të konsiderueshme midis të dhënave të raportuara në vitin 2023 me të dhënat e raportuara në vitin 2022.

Në të vërtetë, ARRU gjatë vitit 2022 ka kërkuar nga të gjitha KRU-të të instalojnë ujëmatës funksional në të gjitha pikat e prodhimit / trajtimit të ujit. Pas instalimit të ujëmatësve, është vërtetuar që diferenca midis ujit që është matur me ujëmatës është shumë më e madhe se sa vëllimi i ujit i raportuar pa matje për të njëjtat burime.

Uji i prodhuar si treguesi kyç, ka ndikim tek një numër i treguesve të tjerë të performancës. Për këtë arsye, për të qenë transparent me publikun dhe me palët tjera të interesit, ARRU ka vendosur të publikojë në raport vetëm treguesit që janë të saktë dhe të verifikuar.

2. PERFORMANCA E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

2.1 PERFORMANCA OPERATIVE - FURNIZIMI ME UJË

2.1.1 Cilësia e Ujit

Kualiteti i ujit që iu ofrohet konsumatorëve është element kyç i shërbimit të furnizimit me ujë duke pasur parasysh rëndësinë që ka për shëndetin publik. Kualiteti i ujit të pijshëm që iu ofrohet konsumatorëve nga ofruesit e shërbimeve të ujit, duhet të jetë sipas standardeve në fuqi në Kosovë të përcaktuara në Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 10/2021 për ‘Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor’.

Edhe në këtë raport, analiza dhe vlerësimi i cilësisë kundrejt standardeve në fuqi të kualitetit të ujit, është bërë në bazë të të dhënave të raportuara nga IKSHPK në ARRU¹.

Niveli i pajtueshmërisë, merr parasysh numrin e mostrave të kryera dhe përqindjen e rezultateve që plotësojnë standardin e cilësisë së ujit, në dy aspekte: fiziko-kimike dhe bakteriologjike.




Figura - 1 Norma e cilësisë së testeve bakteriologjike, në përputhje me standardet vendore

Në aspektin bakteriologjik, në përputhje me standardet bakteriologjike kanë qenë 98.8% nga numri total 12,440, mostrave të analizuar. Në raport me vitin 2021, ka një progres të vogël në nivel sektori.

Përqindja më e lartë e testeve të dështuara bakteriologjike në 2022, janë raportuar nga KRU ‘Bifurkacioni’ (4.8%) përcjellur nga KRU ‘Gjakova’ (4.4%). Nga ana tjetër performancë me të mirë në aspektin e cilësi bakteriologjike është raportuar nga KRU ‘Hidroregjioni jugor’ dhe ‘Hidrodrini’.

¹ Cilësia e ujit për KRU Prishtina është bërë në bazë të të dhënave të raportuara nga ana e kompanisë




Figura - 2 Norma e cilësisë së testeve fiziko-kimike në përputhje me standardet vendore

Në vitin 2022 krahasuar me 2021, shkalla e përmbushjes së kualitetit të ujit të trajtuar të përcaktuar me standarde (kimike dhe bakteriologjike) në nivel sektori është në 98%.

Nga aspekti fiziko - kimik uji i cili furnizohet nga kompanitë publike, gjatë vitit 2022 në raport me 2021 është në një shkallë më të ultë të përputhshmërisë me parametrat e lejuar nga numri total 12,121 i mostrave të testuara, 97.2% e tyre, ishin në përputhje me standardet vendore.

Siç shihet edhe nga figura 2, problemet me të mëdha aktualisht janë, në KRU 'Hidrodrini' me 87% të testeve në përputhje me standardet, në këtë normë ndikim ka pas dështimi i sigurimit të pranisë së klorit residual², po ashtu dështime më të larta të cilësisë së ujit në këtë aspekt, në këtë vit janë raportuar edhe për KRU 'Gjakova'.

Reduktimet e ujit në disa kompani si dhe ndërprerjet e shpeshta të ujit për shkak të plasjeve në gypat e ujësjellësit, si dhe situata meteorologjike (reshjet e mëdha të cilat e karakterizuan vitin) ishin faktorë të cilët ndikuan në cilësinë e ujit të ofruar në vitin 2022.

Duke marrë parasysh se ndër kërkesat kyçe të udhëzimit administrativ (QRK) Nr. 10/2021 për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor është edhe monitorimi operacional i cili duhet të bëhet nga vet KRU dhe për këtë ato duhet të kenë laboratore të akredituara nga institucioni përgjegjës vendor³, prandaj në këtë drejtim, sugjerojmë KRU-në të angazhohen për akreditimin e laboratorëve të tyre, duke i ngritur kapacitetet profesionale dhe teknike për monitorimin dhe testimin e cilësisë së ujit të furnizuar prej tyre.

2.1.2 Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit

Në figurën 3 është dhënë përqindja e popullatës brenda çdo zone të përkufizuar të ofruesit të shërbimeve për furnizim që ka qasje në shërbimet publike të ujit nga KRU. Siç shihet, rreth 21% e popullatës (sidomos zonat rurale) aktualisht nuk shërbehen nga ofruesit e shërbimeve publike, një pjesë e tyre kanë furnizim të kufizuar të ujit p.sh. puse apo burime jashtë përgjegjësisë të KRU-së.

² Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 10/2021, mungesën e Klorit residual në normën e kërkuar e merr si dështim në cilësinë e ujit,

³KRU Gjakova, Hidroregjioni Jugor dhe Hidromorava i kanë të akredituara laboratorët nga Drejtoria e Akreditimit të Kosovës




Figura - 3 Përqindja e mbulueshmërisë së popullatës me shërbime të ujësjellësit nga KRU

Përveç KRU 'Mitrovica', ofruesit e tjerë të shërbimeve nuk kanë raportuar ndryshime në shifra për shtrirje të shërbimeve gjatë vitit 2022 në raport me 2021. KRU 'Gjakova' ka shkallën më të lartë të shtrirjes së shërbimeve me ujësjellës me 99% mbulueshmëri të zonës së saj, përderisa KRU Hidromorava 61% dhe Hidroregjioni Jugor 66%, raportojnë norma më të ulëta, të mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit në kuadër të zonave tyre respektive. Numri i konsumatorëve të shërbyer nga KRU aktualisht është rreth 436,621 e cila vlerë nëse krahasohet me vitin paraprak 2021 është më e lartë për rreth 20,000 apo shprehur në përqindje 5%.

Në Kosovë, ka politika qeveritare për shtrirje dhe integrim të shërbimeve të ujit, në këtë drejtim, qeveria e Kosovës pati hartuar dokumente strategjike të cilat u identifikuan me një numër të konsideruar të popullatës dhe të fshatrave të Kosovës me sisteme të veçanta të ujësjellësit të cilat nuk administroheshin nga KRU-ja, ato vendosen objektiva të cilat patën rezultate modeste, si duket hasën në vështirësi në implementimin e tyre, për shkak të mungesës së vullnetit të KRU-së për integrimin e këtyre sistemeve, rezistenca e komunitetit që ta japin në menaxhim të KRU-ve sistemin e "tyre" të ujësjellësit, si dhe mos koordinimi i mirë ndërmjet të gjitha institucioneve relevante Qeveritare, ARRU, IKSHP, Komunave etj. Sido që të jetë shumica e KRU-ve e sidomos KRU (Hidromorava, Hidroregjioni Jugor, Prishtina dhe Mitrovica) kanë potencial më të madhe të rritjes së bazës së tyre të konsumatorëve. Prandaj ARRU sugjeron KRU-në që të bëjnë sa më shpejtë integrimin e komunave dhe skemave rurale të ujësjellësve, meqenëse këtë e shohim si të rëndësishëm për KRU-në si mundësi e realizimit të të ardhurave shtesë, por njëkohësisht edhe të rëndësishëm për vetë popullatën meqenëse do të marrin shërbime me të qëndrueshme dhe të sigurta.

2.1.3 Matja e ujit

Është e drejtë themelore e konsumatorëve dhe njëkohësisht edhe obligimi ligjor për Kompanitë Rajonale të Ujësjellësve (KRU) në Kosovë, që për konsumatorët e tyre të, sigurojnë faturim: të saktë, të drejtë, të ligjshëm dhe transparent për shërbimet e ujit përmes ujëmatësit, për më tepër matja e ujit të faturuar për konsumatorët gjithashtu është edhe një mjet i rëndësishëm për kontrollin e konsumit dhe humbjeve të ujit.




Figura - 4 Përqindja e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës

Analiza e rezultateve tregon se mbulimi i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës në nivel të përgjithshëm gjatë vitit 2022 është 98.6% dhe është rritur për 0.6% nga viti 2021.

KRU 'Gjakova', 'Bifurkacioni', 'Hidrodrini', 'Hidroregjioni Jugor', janë kompanitë me normën e plotë të faturimit të konsumatorët shtëpiak me ujëmatës. Përderisa të KRU 'Mitrovica', ky tregues qëndron me normën prej 91% ndonëse ka shënuar përmirësim ende mbetet në nivel shumë të ultë të ujëmatjes për konsumatorët e tyre. Përndryshe pajisja e konsumatorëve me ujëmatës, atyre komercial - industrial si dhe atyre institucional është pothuajse e plotë.

ARRU, duke qenë e informuar se shumë ankesa të konsumatorëve kanë të bëjnë me parregullsitë në faturimin e konsumatorëve dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore në këtë aspekt, në vazhdimësi ka kërkuar që KRU t'i pajisin të gjithë konsumatorët e tyre me ujëmatës dhe faturimin e tyre, ta bëjnë ekskluzivisht përmes leximit të rregullt të ujëmatësve.

Matja e ujit është po ashtu një mjet i domosdoshëm për të menaxhuar në mënyrë efikase zvogëlimin e humbjeve të ujit si dhe nxitë për kursimin e ujit, kjo fiton peshë më të madhe sidomos tek KRU të cilat përballen me sfidën e përmbushjes së nevojave të popullsisë së tyre me ujë të pijshëm.

Është realitet për momentin se shumica dërmuese e ujëmatësve në vend janë në shërbim për rreth 10-15 vjet apo më shumë ku në masë të madhe është cenuar edhe funksionaliteti i tyre. Është përgjegjësi e ofruesve të shërbimeve që ujëmatësit të mirëmbahen dhe zëvendësohen sipas një programi zbatues nga e tyre. ARRU ka diskutuar këtë çështje me ofruesit e shërbimeve dhe institucionet përgjegjëse në punëtorin e organizuar, me ç' rast janë adresuar çështje të rëndësishme të lidhura me ujëmatësit dhe saktësinë e faturimit.

2.1.4 Ankesat

Është e drejtë e garantuar e konsumatorëve për t'u ankuar kur ata nuk marrin shërbimin e duhur nga ofruesi i tyre i shërbimeve. Ankesat janë kritike në matjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve. Ky tregues, paraqet numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar nga KRU, prej konsumatorëve të tyre për shërbimin e ujësllësit dhe paraqet, shprehjen e pakënaqësisë të proceduar në formë të shkruar apo verbale.

Tabela - 1 Ankesat e konsumatorëve për shërbimet e ujit

KRU	Ankesat teknike			Ankesat komerciale		
	2021	2022	Raporti krahasues: 2022/2021	2021	2022	Raporti krahasues: 2022/2021
PR	3,905	2,912	-25%	1388	1,658	19%
PZ	2,021	1,988	-2%	670	681	2%
PE	2,296	2,431	6%	43	247	474%
MIT	6,785	4,440	-35%	85	141	66%
GJA	3	0	-100%	338	264	-22%
FE	54	64	19%	137	303	121%
GJI	244	273	12%	339	518	53%
Totali	15,308	12,108	-21%	3,000	3,812	27%

Numri i përgjithshëm i ankesave për vitin 2022, është zvogëluar në përgjithësi në raport me vitin 2021. Kjo është e evidente në adresimin më të ultë të ankesave teknike në të gjitha KRU përjashtuar KRU 'Bifurkacionin', 'Hidrodrinin' dhe 'Hidromoravën', në total numri i ankesave teknike është për 21% më pak se sa në vitin 2021. Nga ana tjetër numri i ankesave komerciale është në rritje. Nga totali prej 3000 ankesave në 2021 numri i tyre është rritur për 27% apo rreth 800 sish me tepër, kjo tregon një pakënaqësi të përgjithshme të konsumatorëve për performancën e KRU në trajtimin e aspekteve komerciale të tyre.

Pjesa më e madhe e ankesave teknike në furnizim me ujë të raportuara nga KRU, ishin të lidhura me aspektin operativ (ndërprerje të ujit, mungesë presioni dhe rrjedhje të ujit), përderisa sa i përket aspektit financiar (komercial), konsumatorët më tepër janë ankuar në aspektet të cilat lidhen me borxhet (kontestim të borxhit, zbritja shlyerja e borxhit), si dhe faturimit (faturimi paushall). Në 2022 kemi rritje të numrit të ankesave të konsumatorëve për shkak të mbingarkimit në faturat e tyre, mos leximit të rregullt të ujëmatësit etj.

KRU 'Prishtina' si kompani me numër më të madh ankesash ka raportuar zbritje të konsiderueshme në ankesat e natyrës teknike përgjatë 2022 në raport me vitin 2021, përderisa numri i ankesave komerciale në KRU 'Prishtina' është rritur për 19%. Rritjen më të lartë në numrin e ankesave, në të dyja aspektet e kanë shënuar KRU 'Hidromorava', 'Bifurkacioni' dhe 'Hidrodrini'.

Përditësimi, klasifikimi dhe analiza e të dhënave të ankesave të konsumatorëve, janë elemente të rëndësishme të monitorimit dhe përmirësimit të performancës, ankesat ofrojnë informacione rreth pikave të dobëta në ofrimin e shërbimeve. Për këto arsye edhe ARRU çështjes së azhurnimit të ankesave të konsumatorëve vazhdimisht i ka kushtuar vëmendje. Kohëve të fundit të dhënat për ankesat, janë më të besueshme për faktin se të gjitha KRU, kanë module të avancuara të regjistrimit dhe trajtimit të ankesave të konsumatorëve.

2.1.5 Konsumatorët e prekur nga presioni i ultë

Ky tregues definon numrin e pronave që ndikohen rregullisht nga presioni i ultë duke përjashtuar rastet aksidentale të herë pas herëshme të rënies së presionit. Është e evidente se menaxhimi i duhur i presionit, përveç ndikimit të drejtpërdrejtë që ka në kënaqshmërinë e konsumatorëve me shërbimin e ofruar, është edhe njëri prej elementeve të rëndësishëm në menaxhimin e humbjeve

fizike të ujit si dhe ruajtjen e jetëgjatësisë së rrjetit të ujësllësit. Është obligim ligjorë që furnizuesit vendor të marrin përsipër të sigurojnë një furnizim në një "nivel referimi" mbi 1,5 deri 7.0 barë, në gypin e kyçjes së konsumatorit.




Figura - 5 % e pronave me presion të ultë në rrjetin e ujësllësit

Gjatë vitit 2022, KRU 'Bifurkacioni', 'Hidrodrini', 'Hidroregjioni Jugor' si dhe KRU 'Prishtina', kanë raportuar të kenë vështirësi në sigurimin e presionit minimal për një numër të konsumatorëve të tyre. Nga KRU e tjera, nuk ka qenë e mundur të sigurohen të dhëna. Në përgjithësi të dhënat për presionin e ujit, ende duhet konsideruar si jo fort të besueshme meqenëse asnjëra nga kompanitë nuk ka ndonjë program të mirëfilltë rreth menaxhimit dhe monitorimit të presionit si dhe mbajtjes së evidencës. Është mundshme që situata të jetë edhe më e keqe se sa tregon figura 5.

Është evidente se asnjë nga KRU-të, nuk kanë të zhvilluar programe për menaxhimin e presioneve në zonat e tyre të shërbimit. Menaxhimi dhe sjellja e presioneve në nivelet e lejuara, është e rëndësishme për ruajtjen e infrastrukturës, dhe njëkohësisht është shumë e domosdoshme gjatë aktiviteteve të menaxhimit të humbjeve fizike si dhe sigurimit të cilësisë së ujit. Është e njohur se me një presion adekuat dhe brenda vlerave parametrike ligjore të përvetësuar, do ta mban larg ujin e kontaminuar që të mos hyjë në rrjetin e ujësllësit.

2.1.6 Vazhdimësia e furnizimit me ujë

Ky tregues pasqyron numrin e pronave të prekura/ndikuara nga disponueshmëria, të ndara në tri kategori të pronave: (i) me 24 orë shërbim në ditë, (ii) me 18-23 orë shërbim në ditë dhe (iii) ato me më pak se 18 orë shërbim në ditë.

Në përgjithësi furnizimi me ujë në Kosovë, ishte përmirësuar në vazhdimësi si rezultat i investimeve në ngritjen e kapaciteteve prodhuese në të gjitha KRU, megjithatë furnizimi i vazhdueshëm për 24 orë në ditë ende është aktual në disa prej tyre.

Tabela - 2 Përqindja e konsumatorëve me furnizim <18 orë, 18-23 orë dhe 24 orë gjatë 2021 dhe 2022

	<18 h furnizim %		18-23 h furnizim %		24 h furnizim %	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022
KRU						
PR	0.8%	4.0%	2.2%	2.2%	97%	93.8%
PZ	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	100%	100%
PE	3.8%	6.0%	0.0%	0.0%	96%	94%
MIT	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	100%	100%
GJA	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	100%	100%
FE	3.8%	1.8%	2.5%	2.3%	93.7%	95.9%
GJI	40.7%	2.6%	0.0%	0.0%	59%	97.4%

Vetëm KRU 'Gjakova', 'Mitrovica' dhe 'Hidroregjioni Jugor' kanë raportuar se furnizojnë konsumatorët e tyre 24 orë me ujë të pijshëm.

KRU, të cilat vazhdojnë të kenë vështirësi të mëdha edhe në vitin 2022, me furnizimin me ujë ende mbeten KRU 'Prishtina', 'Hidrodrini', 'Bifurkacioni' dhe 'Hidromorava'. Këtë vit nga KRU 'Hidromorava' dhe KRU 'Bifurkacioni', është raportuar të ketë përmirësim në këtë drejtim si rezultat i resurseve me te qëndrueshme në burime të ujit.




Figura - 6 Vazhdimësia e furnizimit me ujë

Në KRU 'Bifurkacioni', është përmirësuar vazhdimësia e furnizimit për disa fshatra rurale të cilat në të kaluarën kanë pasur reduktime të ujit, kryesisht gjatë muajve të verës edhe në KRU 'Hidrodrini' vazhdojnë problemet në sigurimin e furnizimit të rregull me ujë për 2,300 konsumatorë, në dy zona të qytetit të Pejës dhe Vitomericës, gjatë muajve të verës për shkak të rënies së presionit.

Gjendja në KRU 'Hidromorava' po ashtu është përmirësuar dukshëm në 2022, në raport me vitin 2021, ku rreth 40% të konsumatorëve, kishin reduktime të ujit për shkakun e mungesës së resurseve në burim të ujit si pasojë e thatësisë e cila mbretëroi në këtë regjion në vitin 2021 dhe pjesërisht edhe në vitin 2022.

KRU 'Prishtina', edhe gjate vitit 2022, ka vazhduar të ketë vështirësi në furnizimin e rregullt për rreth 6% të konsumatorëve në disa lokalitete si: Bardhi i madh, Sllatinë, komuna e Fushe Kosovës, disa fshatra të Podujevës dhe Lipjanit, kryesisht reduktimet ishin aplikuar gjatë sezonit të verës.

Situata e pasqyruar në figurën 6, ka qenë larg asaj që mund të quhet ideale dhe në përgjithësi mund ti adresohet këtyre arsyeve: në disa KRU ekzistojnë mungesë e resurseve dhe kapacitete të limituara për trajtimin e ujit, rrjetet ekzistuese të ujësllësit janë në gjendje të dobët, që rezultojnë në humbje të mëdha, si dhe kyçjet e paligjshme dhe ilegale të cilat janë burim keqpërdorimi enorm i ujit të pijshëm.

Në lidhje me vazhdimësinë e furnizimit, kemi shprehur shqetësim në besueshmërinë e të dhënave, meqenëse kompanitë nuk kanë një sistem të besueshëm të azhurnimit të dhënave (mungon SCADA sistemi në rrjetin shpërndarës si dhe përditësimi i të dhënave mbi regjionet dhe konsumatorët e prekur nga reduktimet në ndonjë aplikacion të qëndrueshëm siç është GIS.

2.1.7 Plasaritja e gypave ne rrjetin e ujësllësit

Ky tregues, paraqet numrin e plasjeve të gypave të ujësllësit brenda një viti në raport me 100 km gjatësi të gypave të rrjetit, dhe pasqyron gjendjen dhe performancën e rrjetit shpërndarës të ujësllësit.




Figura- 7 Defektet në rrjetin e ujësllësit

Plasaritjet/defektet e gypave me të cilat janë ballafaquar KRU (matur si numri i plasaritjeve për 100 km të gypit në vit) përgjithësisht janë të larta në mbi 169 sosh për 100 km gyp, në mesatare te sektorit duke filluar nga ajo më pak se 81 për KRU 'Hidromorava' deri KRU 'Hidroregjioni Jugor' me 245, pra me performancë me të dobët të rrjetit të ujësllësit. Kjo gjendje e numrit të plasjeve /defekteve të rrjetit për 100 km, na tregojnë gjendjen e dobët të rrjetit të ujësllësit dhe sa më e lartë të jetë kjo normë aq më shumë ndikon në humbjen e ujit dhe në kualitetin e tij.

Numri i lartë i plasjeve arsyetohet me faktin se KRU, në përgjithësi janë duke shpenzuar shumë pak në mirëmbajtjen kapitale të rrjetit të furnizimit me ujë. Performanca e dobët e rrjetin kryesorë të furnizimit, kryesisht është ndikuar nga një sërë faktorësh, duke përfshirë llojin (materialin) e gypave, vjetërsinë e rrjetit, standardin e mirëmbajtjes së kryer nga ofruesi i shërbimit, etj. Sipas disa standardeve ndërkombëtare (i pranuar edhe nga ARRU)⁴ për vlerë me të lartë se 50 defekte (plasje)

⁴Udhëzuesi për planifikimin e menaxhimit të aseteve-ARRU-2011

për 100 km të rrjetit të gypave, është i nevojshëm intervenim urgjent për rehabilitimin e sistemit të gypave. Pa dyshim se ky fakt dhe pa përjashtimisht një normë e tillë e lartë në të gjitha KRU, ndikon në domosdoshmërinë për investime urgjente në përtërijnë dhe mirëmbajtën e rrjetit të ujësjetës.

2.2 PERFORMANCA FINANCIARE-FURNIZIMI ME UJË

2.2.1 Vlera monetare e shitjeve

Në këtë pjesë të raportit është analizuar performanca financiare e kompanive, e cila është thelbësore për qëndrueshmërinë financiare të kompanive.




Figura – 8 Përqindja e shitjeve (faturimit ne Euro) në raport me planin

Ishte e pritshme se vlera e shitjeve për çdo KRU të ishin shumë më të ulëta se sa vlerat e planifikuara të shitjeve për shkak të mos realizimit të shitjeve sasiore ashtu siç ishte parashikuar.

Mesatarja e sektorit i në 2022 ishte për 12% më e ultë se plani, për më tepër kjo është performancë ma e dobët për 5% se ajo në vitin 2021.

Përveç KRU 'Prishtina' e cila ka një performancë më të mirë të vlerës së shitjeve të planifikuara në vitin 2022 në raport me vitin 2021. Të gjitha KRU e tjera kanë treguar performancë më të dobët në arritjen e objektivës së shitjeve në 2022 në krahasim me vitin 2021, sidomos kjo është shumë e theksuar tek KRU 'Gjakova' me 24% dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor' me 9%.

Tabela 3, më poshtë paraqet shifrat statistikore të performancës së treguar për shitjet e ujit në krahasim me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU-së për procesin e rishikimit tarifor për vitet 2022 dhe 2021.

Tabela - 3 Vlera e shitjeve të realizuara dhe planifikuara 2021-2022

Vlera e shitjeve (Euro)							
KRU	2021			2022			Raporti:
	Planifikuar	Realizuar	raporti: real./plan.	Planifikuar	Realizuar	raporti: real./plan.	realizimi 2022/realizimi 2021
PR	14,670,957	12,926,586	88%	15,395,857	13,939,314	91%	7.83%
PZ	4,167,400	3,964,962	95%	4,583,183	3,924,934	86%	-1.01%
PE	3,721,959	3,517,253	95%	3,692,971	3,336,180	90%	-5.15%
MIT	3,347,663	3,325,071	99%	3,771,479	3,726,858	99%	12.08%
GJA	4,300,408	4,194,101	98%	4,767,563	3,508,704	74%	-16.34%
FE	1,836,891	1,779,260	97%	2,170,279	1,975,991	91%	11.06%
GJI	2,106,189	1,924,245	91%	2,205,954	1,957,050	89%	1.70%
Sektori	34,151,467	31,631,479	93%	36,587,285	32,369,031	88%	2.33%

Vlera e shitjeve të realizuara për vitin 2022 në nivel të sektorit për furnizim me ujë, ishte 32.4 mil.€ ndërsa ajo e planifikuar 36.6 mil.€ do të thotë se është më e ultë për 4.2 mil. €, apo siç e cekem më lartë për 12 % më pak se plani.

Rrjedhimisht kjo ndikon në të ardhurat e pamjaftueshme nga shitjet për të përmbushur nevojat financiare të KRU-së, në veçanti për financimin e mirëmbajtjes dhe rritjes kapitale.




Figura - 9 Përqindja e shitjeve të furnizimit me ujë gjatë 2022, në raport me vitin 2021

Përkundër dështimit për të përmbushur caqet e shitjeve, vlera absolute e shitjeve në 2022 në raport me 2021 në nivel sektori është për 2.3% më e lartë. Vlen të theksohet se normat e shitjeve ishin më të larta për KRU 'Mitrovica' dhe 'Bifurkacioni', 'Prishtina' dhe në një normë më të vogël edhe tek KRU 'Hidromorava'.

Tek KRU ‘Hidroregjioni Jugor’ 1%, ‘Hidrodrini’ 5.15% dhe ‘Gjakova’ 16.34% normat e shitjeve janë negative në krahasim me vitin 2021.

2.2.2 Shpenzimet kapitale për ujësjellës

Përmes proceseve tarifore ARRU në baza vjetore lejon një vlerë të konsiderueshme të mjeteve financiare për KRU dedikuar shpenzimeve kapitale për mirëmbajtje dhe avancim të bazës së aseteve e domosdoshme për të ofruar shërbime të qëndrueshme të furnizimit me ujë.

Tabela - 4 Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake për vitet 2021 dhe 2022

	Burimet vetanake të investimit				
	2021	2022			
KRU	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2022: realizim/planifikim	% krahasuese: 2022/2021 (realizim)
PR	497,374	1,563,100	525,526	33.6%	6%
PZ	181,310	581,200	594,062	102.2%	228%
PE	242,803	855,000	381,219	44.6%	57%
MIT	227145	390,000	5,246	1.3%	/
GJA	296,833	988,039	600,850	60.8%	102%
FE	7,464	311,990	83,255	26.7%	1015%
GJI	25,559	335,530	133,123	39.7%	421%
Sektori	1,478,488	5,024,859	2,323,281	46.2%	57%

Në vitin 2022 në total rreth 5.0 mil. € ishin lejuar përmes procesit tarifor për ti mbuluar projeksionet kapitale në shërbimin e furnizimit me ujë. Ne jemi të zhgënjyer kur shohim se shpenzimet kapitale të realizuara nga KRU në vitin 2022, ishin më pak se gjysma e atyre të planifikuara.

Normën me të lartë të investimeve kapitale në raport me planin në vitin 2022 e kishte realizuar KRU ‘Hidroregjioni Jugor’ me 102%, ishin rreth 0.6 mil.€ mjete vetanake të realizuara në mirëmbajtje dhe ndërrim të rrjetit të furnizimit me ujë, përndryshe në raport me vitin paraprak 2021, investimet vetanake në këtë kompani janë mbi dy herë më të larta. Nga ana tjetër vetëm 1.3 %, e investimeve të planifikuara është realizuar nga KRU ‘Mitrovica’.

Vlera investimeve në 2022 në nivel të sektorit ishte për 57% më e lartë se sa në vitin 2021, kjo kishte një ndikim të lehtë në performancën e rrjetit të ujësjellësit.

Sido që të jetë dështimi gjegjësisht mos realizimi i shpenzimeve të planifikuara, sidomos atyre të dedikuara për mirëmbajtje kapitale, padyshim se rezulton me përkeqësim të bazës së aseteve dhe rënie të niveleve të shërbimit ku norma aktuale e defekteve në rrjet si dhe niveli i lartë i humbjeve të ujit është dëshmi për këtë dështim.

Tabela - 5 Investimet e realizuara dhe planifikuara nga grantet për vitet 2021 dhe 2022

KRU	Investimet prej granteve				
	2021	2022		% krahasuese 2022: realizim/ planifikim	% krahasuese: 2022/2021 (realizim)
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)		
PR	30,210	1,980,000	147,266	7.4%	387%
PZ	135,902	26,199,715	136,918	0.5%	1%
PE	0	0	0	0.0%	/
MIT	161,178	0	410	/	-100%
GJA	22,778	9,535,693	104,996	1.1%	361%
FE	0	4,010,000	360	0.0%	/
GJI	0	2600000	76847	3.0%	/
Sektori	350,068	44,325,408	466,797	1.1%	33%

Një shumë e shpenzimeve kapitale ishte planifikuar për tu realizuar nga donacionet, nga vlera e prej 44.3 mil. €, ishin realizuar vetëm 1.1% apo 0.46 mil. €.

Një shumë prej 26.2 mil.€, vlerë investive dedikuar për mirëmbajtje dhe rritje kapitale ne trajtim si dhe distribuim te ujit ishin planifikuar nga KRU 'Hidroregjioni Jugor', në gjithë zonën e shërbimit të saj, por realizimi i tyre ishte shumë i ultë 0.5%. Përndryshe KRU 'Hidrodrini' dhe KRU 'Mitrovica' nuk kishin planifikuar por edhe nuk kanë realizuar asnjë donacion në vitin 2022.

Tabela - 6 Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitet 2021 dhe 2022

	Burimet vetanake të investimit + grantet				
	2021	2022		% krahasuese 2022: realizim/ planifikim	% krahasuese: 2022/2021
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)		
Sektori-InvVet	1,478,488	5,024,859	2,323,281	46.24%	57%
Sektori-Grant	350,068	44,325,408	466,797	1.05%	33%
Sektori	1,828,556	49,350,267	2,790,078	5.65%	53%

Nga tabela, e mësipërme vërehet se realizimi i investimeve kapitale në nivel sektori nga mjetet vetanake ishte 46.2%, përdërisa nga mjetet e donacioneve ishin realizuar 1.05%.




Figura - 10 Shpenzimet kapitale të realizuara nga te hyrat vetanake dhe grantet për furnizim me ujësjellës në raport me planin

Nga totali i investimeve kapitale (vetanake dhe grante) në furnizim me ujë në mesatare janë realizuar 5,7%, më shumë investime janë realizuar nga KRU 'Hidrodrini', ndonëse planifikimet ishin shumë modeste.

2.3 PERFORMANCA OPERATIVE-SHËRBIMI I UJËRAVE TË NDOTURA

2.3.1 Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara

Kompanitë të cilat bëjnë trajtimin e ujërave të ndotura, KRU 'Hidrodrini', 'Gjakova' dhe KRU 'Mitrovica' kanë raportuar se trajtimi i ujërave të ndotura dhe shkarkimi i tyre është brenda standardeve të lejuara vendore, përderisa nga KRU 'Hidroregjioni Jugor', nga 167 teste të bëra 17 prej tyre, janë raportuar si të dështuara. Vlen të përmendet se në kuadër të ITUN-së, janë ndërtuar laboratorë të pajisur me aparatura moderne.

Aspektet ligjore dhe vlerat parametrike të lejuara për trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të ndotura janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 30/2014, i cili është në mbikëqyrjen institucionale nga MMPH-ja.

Ne po shpresojmë se viteve në vijim, raportet vjetore për cilësinë e ujit të shkarkuar nga KRU, do të sigurojmë nga kjo ministri, gjegjësisht nga departamenti përkatës.

2.3.2 Shpeshtësia e bllokimit të rrjetit të kanalizimit

Numri i bllokimeve për 100 km gjatësi të rrjetit, tregon besueshmërinë e sistemit të grumbullimit të ujërave të ndotura kjo matje bëhet përmes numrit të vërshimeve ose bllokimit të rrjetit të kanalizimit për 100 km për gjatë një viti.




Figura - 11 Numri i bllokimeve për 100 km gjatësi të rrjetit

Në nivel sektori trendi i bllokimeve të kanalizimit është në përmirësim, megjithatë niveli prej 512 bllokimeve për 100 km të rrjetit është tepër i lartë.

Rezultatet e raportuara në vitin 2022, tregojnë një gamë të gjerë ndryshimesh të performancës së KRU nga 207 bllokime për 100 km të gypave KRU 'Bifurkacioni' deri në 1,016 bllokime të KRU 'Gjakova', kjo tregon një performancë jo të mirë.

Si duket shkaqet për një nivel kaq të lartë të bllokimeve është neglizhenca dhe mirëmbajtja jo adekuate e sistemit të kanalizimit. Po ashtu viti 2022, ka qenë i karakterizuar me një mot me reshje i cili ka shkaktuar edhe vërshime të herë pas hershme në pjesë të ndryshme të vendit. KRU duhet të kenë qasje më pro aktive në pastrimin dhe riparimin e rrjetit. Ato duhet që në përputhje me obligimet ligjore të bëjnë inspektimin, si dhe pastrimin e tërë sistemit të kanalizimit.

2.3.3 Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizim)

Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit është e definuar si përqindje e popullsisë, brenda zonës së shërbimit që kanë shërbime të kanalizimit nga KRU.




Figura - 12 Mbulueshmëria e popullatës me shërbime të ujërave të ndotura

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizimi) në nivel sektori nuk ka shënuar ndonjë progres, ajo edhe tutje ka mbetur në nivelin 65%.

Po ashtu edhe në nivel të KRU përjashtuar KRU 'Prishtina', gjendja ka mbetur e njëjtë në këto dy vite.

KRU 'Hidrodrini' por edhe KRU 'Hidromorava', kanë një nivel të ultë të shtrirjes së shërbimit me këtë shërbim, pra janë dy kompani të cilat kanë hapësirë të konsiderueshme për përmirësim.

KRU 'Prishtina' dhe 'Bifurkacioni', janë kompani të cilat për dallim nga kompanitë e tjera vendore kanë nivel më të pranueshëm të mbulimit me shërbime të ujërave të ndotura e para me mbi 79%, e dyta me 74%.

Trajtimi i ujërave të ndotura nga KRU mbetet ende i ulët me vetëm 25% nga tërë sasia e ujërave të ndotura të faturuara konsumatorëve nga të gjitha KRU, apo rreth 8.1 % e popullatës kryesisht në zonën e shërbimit të KRU 'Hidroregjioni Jugor' me 15%, 'Gjakova' 17.9% dhe 'Hidrodrini' 22.9%. Disa ITUN me kapacitete të vogla janë në menaxhim të KRU 'Mitrovica' dhe 'Prishtina'.

Këto nivele janë shumë më të ulëta se normat e mbulueshmërisë për standardet mjedisore të Evropës dhe nëse Kosova do që të përmbush aspiratat në përputhje me standardet e BE janë të domosdoshme investime të konsiderueshme në zgjerimin e rrjetit të ujërave të ndotura dhe trajtimin e tyre. Megjithatë ne e vlerësojmë, se investimet e tilla janë të kushtueshme dhe niveli i investimeve të kërkuara nuk mund të ndërmerret pa mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar për zhvillim. Ne po shpresojmë që në vitet e ardhshme ky shërbim do të jetë më i përmirësuar, meqenëse kemi hyrë në një fazë të planifikimeve, investimeve dhe ndërtimeve intensive të impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura edhe në zonat e tjera të menaxhuara nga KRU.

2.3.4 Ankesat

Treguesi në vijim paraqet numrin e ankesave që konsumatorët i adresojnë tek kompanitë e tyre, në lidhje me shërbimin e ujërave të ndotura (kanalizimit) dhe pasqyron nivelin e kënaqëshmërisë së konsumatorëve në lidhje me shërbimin e marrë nga ofruesi i tyre i shërbimeve.

Në këtë kapitull janë përfshirë ankesat e natyrës teknike, përderisa për ankesat komerciale adresuar tek KRU referojuni kapitullit ankesat dhe tabelën 1. Ankesat e konsumatorëve për shërbimet e ujit.

Tabela - 7 Ankesat e konsumatorëve në shërbimin e ujërave të ndotura

Ankesat teknike		
KRU	2021	2022
PR	4,047	3,815
MIT	2,972	1,479
PE	52	241
PZ	658	620
GJA	0	0
GJI	33	28
FE	0	2
Spektori	7,762	6,185

Në total nga të gjitha KRU, në vitin 2022, janë raportuar 6,185 sish, të gjitha ankesat kanë të bëjnë me aspektet teknike, sidomos me vërshimet dhe kolapset e rrjetit të kanalizimit.

Numri i lartë i ankesave për aspektet teknike na jep të kuptojmë se problemet në këtë shërbim janë enorme tek KRU 'Prishtina', 'Mitrovica', 'Hidroregjioni Jugor' dhe 'Hidrodrini', nga aspekti operativ, pak ankesa për këtë shërbim janë drejtuar tek 'Bifurkacioni' dhe 'Hidromorava', përndryshe asnjë ankesë nuk është raportuar nga KRU 'Gjakova'.

Ne sugjerojmë KRU që të jenë sa më të përgjegjshme në trajtimin e ankesave, veçanërisht KRU 'Hidrodrini', 'Mitrovica', t'i funksionalizojnë aplikacionin softuerike (CRM), në mënyrë që edhe ankesat e konsumatorëve në lidhje me shërbimin e ujërave të ndotura të azhurnohet dhe përditësohen vazhdimisht.

2.4 PERFORMANCA FINANCIARE-SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA

2.4.1 Vlera e planifikuar e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura (Euro)

Duke marrë parasysh se volumet e shitjeve të ujit ishin nën sasinë e planifikuar, rrjedhimisht edhe vlera e shitjeve aktuale të shërbimeve të ujërave të ndotura gjithashtu është nën vlerat e planifikuara të shitjeve




Figura – 13 Shitjet e ujërave të ndotura në raport me planifikimet

Përfshirë KRU 'Bifurkacioni' dhe 'Mitrovica', asnjëra nga KRU e tjera nuk kanë mundur të arrijnë objektivat e shitjeve të ujërave të ndotura në vitin 2022. KRU 'Hidroregjioni Jugor' dhe KRU 'Mitrovica', për dallim nga KRU e tjera, kanë shënuar trend pozitiv në vitin 2022 në raport me vitin 2021, ndonëse KRU 'Hidroregjioni Jugor' në këtë vit kanë qenë nën cakun e synuar.

2.4.2 Vlera e realizuar e shitjeve të shërbimit të ujërave të ndotura (Euro)

Pavarësisht se nuk janë arritur caqet e shitjeve, të ardhurat nga shitjet për shërbimet e ujërave të ndotura në terma real aktualisht janë rritur për 34.07% edhe pse kryesisht kjo ishte për shkak të ngritjes së tarifave se sa për shkak të performancës së përmirësuar komerciale sidomos tek KRU 'Gjakova' dhe 'Hidrodrini'.




Figura - 14 Vlera e shitjeve të shërbimit me ujëra të ndotura gjatë 2022 në raport me vitin 2021

2.4.3 Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura

Nënkupton shpenzimet totale operative për ujëra të zeza, përfshirë mirëmbajtjen kapitale të ujërave të zeza në raport me ekuivalentët e konsumatorëve shtëpiak për vit.




Figura - 15 Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura

Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura në nivel të sektorit në vitin 2022, kanë shënuar rritje të konsiderueshme nga 6.41 €/m³, në 9.50€/m³ në vitin 2021.

KRU 'Gjakova', 'Prishtina' dhe KRU 'Hidrodrini', kanë shënuar rritje të konsiderueshme të kostove njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura.

Kjo kosto në një masë është për faktin se janë futur në përdorim impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura në disa KRU.

2.4.4 Kostoja totale për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura të realizuara në raport me atë të planifikuar

Ky tregues paraqet raportin në mes koston për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura të realizuara (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/me ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak) dhe koston për njësi të shërbimeve të ujërave ndotura të planifikuara (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/ ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak).




Figura - 16 Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me kostot e planifikuara për njësi(%)

Kostot e planifikuara për njësi që rrjedhin nga rishikimi tarifor 2022 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2022), tek shumica e KRU ishin më të ulëta se sa ato të planifikuara.

Në nivel të sektorit përmbushja e kostove për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura në 2022 është në nivelin prej 54%, aq sa ishte edhe në vitin 2021.

2.4.5 Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura

Me procesin tarifor për vitin 2022 ARRU ka lejuar provizionime të konsiderueshme kapitale (mirëmbajtje kapitale dhe rritje kapitale) nga mjetet vetanake, për të cilat kemi qenë në pritje se të njëjtat do të realizohen drejt qëllimit për të siguruar nivele më të kënaqshme të shërbimit të ujërave të ndotura.

Tabela - 8 Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake për vitet 2021 dhe 2022

	Burimet vetanake të investimit				
	2021	2022		% krahasuese 2022: realizim/ planifikim	% krahasuese: 2022/2021
Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)			
KRU					
PR	21,754	290,500	190,957	65.7%	778%
PZ	2,275	197,000	7,857	4.0%	245%
PE	11,859	50,000	13,494	27.0%	14%
MIT	22,139	150,000	119	0.1%	-99%
GJA	3,885	199,389	2,806	1.4%	-28%
FE	1,415	113,000	14,461	12.8%	922%
GJI	414	114,112	8,797	7.7%	2025%
Sektor	63,741	1,114,001	238,491	21.4%	274%

Nga totali i aprovuar prej 1.1 mil.€ për të shtatë KRU, me keqardhje mund të konstatojmë se nga kjo shumë ishin realizuar vetëm rreth 21.4%. Më shumë investime ishin lejuar për KRU 'Prishtina', nga e cila edhe janë realizuar 65.7% prej tyre. KRU e tjera kanë pasur investime shumë minore në

shërbimin e ujërave të ndotura për periudhën dy vjeçare (2022-2021), sido që të jetë norma e investimeve të realizuara ishte 274%, më e lartë se sa ishte në vitin 2021.

Tabela - 9, Investimet e realizuara dhe planifikuara nga grantet për vitet 2021 dhe 2022

Investimet prej granteve						
KRU	2021		2022		% krahasuese: 2022: realizim/ planifikim	% krahasuese: 2022/2021
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	Investimet kapitale (realizim)		
PR	979,931	1,800,000	510,405	28%	-48%	
PZ	0	20,392,000	43,713	0.2%	/	
PE	0	-	0	/	/	
MIT	15,941	-	41	/	-99.7%	
GJA	529	2,130,000	90	0.004%	-83.0%	
FE	0	-	23	/	/	
GJI	0	-	0	/	/	
Sektori	996,401	24,322,000	554,272	2.3%	-44.4%	

Për vitin 2022, KRU kanë paraparë investime të konsiderueshme kapitale në shumën rreth 24,3 mil.€, të parapara të sigurohen nga donacionet. Në realitet shpenzimet aktuale ishin shumë të ulëta pra vetëm 2.3%. Më shumë mjete investuese janë pritur nga donatorët të realizohen në KRU 'Hidroregjioni Jugor' në mirëmbajtje e sidomos në rritje kapitale në kosto qendrën e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, dhe nga vlera prej 20.4. mil. €, ishin realizuar vetëm 0.2%. Nga 1.8 mil.€. mjete të planifikuara nga KRU 'Prishtina' donatorët kishin realizuar 0.5 mil. € apo 28%.

Tabela - 10 Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitet 2021 dhe 2022

Burimet vetanake të investimit + grantet						
	2021		2022		% krahasuese: 2022: realizim/ planifikim	% krahasuese: 2022/2021
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	Investimet kapitale (realizim)		
Sektori-InvVet	63,741	1,114,001	238,491	21%	274%	
Sektori-Grant	996,401	24,322,000	554,272	2%	-44%	
Total Sektori	1,060,142	25,436,001	792,763	2.79%	-25%	

Në total në sektorin e shërbimeve të ujërave të ndotura, nga mjetet e planifikuara të investohen nga KRU por edhe nga grantet ishin realizuar një përqindje shumë e vogël 3%.




Figura - 17 Shpenzimet kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura ne raport me planifikimet

Ndikimin kryesor për mos përmbushjen e investimeve të planifikuara në lartësinë e aprovuar në shumicë, mund ti atribuohet mos realizimit të objektivave të faturimit dhe të arkëtimit si dhe rritjes së shpenzimeve operative dhe angazhimit me donatoret. Kjo ka rezultuar me mungesën e mjeteve aq të nevojshme për investim, duke mos arritur qëllimin për të siguruar nivele më të kënaqshme të shërbimit të ujërave të ndotura.

Ne presim që në vitet në vijim në këtë shërbim do të këtë investime me të konsiderueshme, një pjesë e tyre tanimë është planifikuar të bëhen si në ndërtimin e ITUN-së po ashtu edhe në përmirësimin e sistemit të kanalizimit.

2.5 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME FINANCIARE E KRU

2.5.1 Arkëtimi i të ardhurave

Efikasiteti i arkëtimit paraqet, raportin e mbledhjes së të ardhurave të faturuara gjatë vitit. Ky është njëri prej treguesve me domethënës i cili krahas efijencës së faturimit dhe reduktimit të humbjeve të ujit, ka impakt të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të kompanisë.




Figura - 18 Shkalla e arkëtimit

Në viti 2021 ne nivel sektori norma e arkëtimit ishte 96%, përderisa në vitin 2022 kjo vlerë ka shënuar rënie në 93%. Ky trend negativ kryesisht mund të jetë për shkakun se në KRU 'Hidrodrini', ka rënie të normës së arkëtimit tek konsumatorët 'komercial-industrial' nga 267% në 92%. Megjithatë vlera e shkallës së arkëtimit vërehet se ka ngecje në disa KRU të tilla si KRU 'Mitrovica', 'Hidrodrini' dhe 'Prishtina'.

KRU 'Gjakova' dhe 'Hidromorava' ishin performuesit më të mirë në 2022, pasi arritën një efijencë të lartë në shkallën e arkëtimit prej 108% 'Gjakova', përkatësisht 101% 'Hidromorava'.

Në KRU 'Mitrovica', rritja e shkallës së arkëtimit është e evidente, ndonëse në këtë tregues performanca e e saj është shumë e ulët, niveli i shkallës së arkëtimit prej 78% në vitin 2022, është ende i pa mjaftueshëm për një afarizëm pozitiv nga kjo kompani.

Tabela - 11 Shkalla e inkasimit e realizuar dhe e planifikuar për vitet 2021 dhe 2022

Shkalla e arkëtimit	Realizuar		Objektiva	
	2021	2022	2021	2022
KRU				
PR	91%	90%	94%	94%
PZ	100%	98%	94%	94%
PE	129%	89%	94%	94%
MIT	74%	78%	79%	86%
GJA	103%	108%	93%	95%
FE	80%	96%	93%	93%
GJI	92%	101%	93%	94%
Sektori	96%	93%	92%	93%

Objektivat e planifikuara nga KRU ‘Hidroregjioni Jugor’, ‘Gjakova’, ‘Bifurkacioni’ si dhe ‘Hidromorava’ ne vitin 2022 ishin përmbushur.

Tabela - 12 Shkalla e arkëtimit sipas kategorive të konsumatorëve dhe totali për vitet 2021-2022

Kategoria e konsumatorëve	Prishtina		Hidroregjioni Jugor		Hidrodri ni		Mitrovica		Gjakova		Bifurkacioni		Hidromorava	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Amvisëri	87%	87%	100%	95%	93%	87%	74%	74%	107%	113%	80%	84%	91%	100%
kom.-industrial	104%	97%	96%	105%	267%	92%	81%	100%	101%	127%	93%	149%	92%	101%
Institucione	97%	104%	108%	107%	107%	94%	66%	85%	84%	51%	42%	119%	100%	102%
Mesatarja	91%	90%	100%	98%	129%	89%	74%	78%	103%	108%	80%	96%	92%	101%

Përderisa norma me e lartë e arkëtimit është tek konsumatorët institucional dhe ata komercial, arkëtimi nga kategoria e konsumatorëve të amvisërisë në shumicën e kompanive mbetet ende sfidë për tu përmirësuar.

Konsumatorët shtëpiak të shërbyer nga KRU ‘Gjakova’, janë paguesit më të mirë të shërbimeve të ujit, ndërsa konsumatorët nga KRU ‘Mitrovica’, me pak kane kryer obligimet financiare ndaj kompanisë së tyre.

Të gjitha KRU duhet të jenë me proaktive në mbledhjen e të hyrave sidomos ndaj borxhlinjve të mëdhenj, bizneseve si dhe konsumatorëve institucional, duke i adresuar borxhet nga aspekti ligjor si dhe aplikimin e masave operative të shkyçjeve por gjithnjë, duke zbatuar procedurat strikte ligjore.

2.5.2 Kthimi ne kapital

Kthimi në Kapital është një komponent e rëndësishme financiare me ndikim në ngarkesën tarifore, si tregues paraqet ndryshimin në mes të të ardhurave vjetore, shpenzimeve operative, mirëmbajtjes kapitale dhe të ardhurave të shlyera të cilat rrinë në raport me bazën rregullatore të aseteve (BRRRA)⁵, për procesin aktual tarifor 2022-2024, vlera e kthimit në bazën rregullatore të aseteve e aprovuar nga ARRU është 4%.

⁵Për më shumë detaje mbi bazën rregullatore të aseteve mund të gjeni në ‘Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit të ARRU’.




Figura - 19 Kthimi në bazën rregullatore të asetëve (BARRA)

Në mesatare të sektorit, kthimi në kapital ka shënuar trend pozitiv, aktualisht ne vitin 2022 është ne normën 5.78% përjashtuar KRU 'Mitrovica', të gjitha KRU e tjera kanë arritur kthime pozitive në 2022, kjo do të thotë, se këto kompani kanë arritur të mbulojnë shpenzimet e tyre (duke përfshirë përtëritjen dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale në bazën rregullatore të asetëve brenda kufijve të të ardhurave të tyre.

Siç vërehet edhe nga figura e mësipërme vlerat e normave për KRU, sillen nga 4.12% tek KRU 'Prishtina' në 18.03% të KRU 'Hidrodrini'. Norma e lartë e kthimit në kapital tek KRU 'Hidrodrini', është për arsye se në vitin 2021 kjo kompani kishte treguar një performancë të mirë në shkallën e arkëtimit, si rezultat i të cilës rritje ishte kryesisht arkëtimi i faturave të papaguara (nga vitet paraprake) prej konsumatorëve komercial-industrial.

Me rritjen e efikasitetit të arkëtimit si dhe me një program të zvogëlimit të shpenzimeve operative KRU do të krijonin mundësi për investime të konsiderueshme në asetet infrastrukturore.

2.5.3 Shpenzimet operative

Ne këtë pjesë të raportit janë analizuar kostot operative të shtatë (7) ofruesve të shërbimeve të ujësllësit dhe ujërave të ndotura në Kosovë, për periudhën dy vjeçare 2022 në raport me vitin 2021.

Shpenzimet operative i referohen kostove të KRU të domosdoshme për funksionimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të ujësllësit dhe ujërave të ndotura, siç janë shpenzimet e personelit, energjia elektrike, derivatet, kemikalet së bashku me kostot e tjera administrative të lidhura me ofrimin e këtyre shërbimeve

Në tabelën 13, kemi dhënë statistika të përmbledhura të shpenzimeve të përgjithshme për shërbimet e ujit të planifikuara si dhe ato të realizuara për vitin 2022 dhe 2021, në nivel sektori dhe specifikisht për secilën KRU, në vlera nominale por edhe të rregulluara për shkallën respektive të inflacionit.

Tabela - 13 Vlera e shpenzimeve operative të realizuara dhe planifikuara

Shpenzimet operative	Realizimi			Planifikimi		
	2021 pa inf.	2021 me inf.	2022 pa inf.	2021 me inf.	2022 me inf.	2022 pa inf
KRU						
PR	10,254,011	11,016,366	10,784,853	11,414,297	12,320,321	11,041,249
PZ	3,872,999	4,160,945	4,081,717	4,600,203	5,157,039	4,621,645
PE	2,903,742	3,119,627	3,104,474	3,035,030	3,519,642	3,154,239
MIT	3,363,490	3,613,555	3,635,502	3,576,403	3,927,452	3,5197,12
GJA	3,642,510	3,913,320	3,901,794	3,815,598	4,732,337	4,241,035
FE	1,517,169	1,629,966	1,579,546	1,690,353	2,173,339	1,947,706
GJI	1,784,596	1,917,275	1,785,009	1,940,286	2,081,966	1,865,820
Sektori	27,338,517	29,371,054⁶	28,872,895	30,072,171	33,912,096	30,391,408

Planifikimet e shpenzimeve për vitin 2022 ishin 30.4 mil.€, përderisa shpenzimet operative të realizuara nga ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë ishin 28.9 mil.€, që do të thotë se shpenzimet e realizuara ishin nën objektivat e planifikuara për rreth 1.5 mil.€ , përndryshe shpenzimet operative ishin për rreth 1.5 mil.€, më të larta në raport me vitin 2021. Në shërbimin e furnizimit me ujësjellës shpenzimet operative ishin rritur më pak, 0.5% përderisa rritje më e lartë e shpenzimeve operative në vitin 2022 në raport me vitin 2021, ka ndodhur në shërbimin e ujërave të ndotura. Rreth 1.4 mil.€, ishin më shumë shpenzime operative në trajtimin e ujërave të ndotura kryesisht në KRU ‘Gjakova’, ‘Hidroregjioni Jugor’, ‘Hidrodrini’ si dhe në KRU ‘Prishtina’. Në shërbimin e furnizimit me ujësjellës KRU ‘Mitrovica’ në vitin 2022, kishte shpenzime operative më të larta për 0.25mil.€ se në vitin paraprak 2021.

⁶Shpenzimet operative me përfshirjen e inflacionit.




Figura - 20 Proporcioni i kategorive të shpenzimeve operative për sektorin 2021 dhe 2022

Gjatë vitit 2022, vetëm kostot e personelit të kombinuara me shpenzimet e energjisë përbëjnë rreth 78% të shpenzimeve operative për funksionimin e shërbimeve të ujit. Kostot e punës përbëjnë 60%, dhe në raport me vitin 2021 është për 1% më e ultë përderisa shpenzimet e energjisë kishin mbetur stabile në normën 18%, po ashtu edhe kategoritë e tjera të shpenzimeve operative si normë kishin mbetur në nivel të njëjtë, përjashtuar kategorinë e shpenzimeve të tjera⁷ të cilat si normë në 2022 janë rritur për 1%.

Në bazë të analizave, janë identifikuar shpenzime të larta po thuajse në të gjitha kategoritë (sidomos, derivatet dhe kemikalet). Reduktimi dhe menaxhimi i tyre në mënyrë efektive është

⁷**Shpenzimet tjera direkte:** paraqesin të gjitha shpenzimet të ndërlidhura me shërbimet komunale, reprezentacion, telekomunikim, shërbime postare, reklama, marrëdhënie me publikun, rekreacion, etj.

esencial dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në përfitimin financiar të kompanisë. Para se gjithash KRU duhet të kenë parasysh racionalizimin e kostove të personelit: rritjen e efikasitetit të stafit, zvogëlimin e UPF, përmirësimin i efijencës së energjisë etj.

Prandaj menaxhmenti duhet të vlerësoj dhe ndërmerr masa të ndryshme për rritjen e të ardhurave dhe uljen e shpenzimeve aty ku është e mundur për të përmirësuar situatën e përgjithshme financiare. Ne vlerësojmë se mundësia për të bërë disa reduktime të shpenzimeve qëndron në të gjitha kosto qendrat e të dyja shërbimeve (sistemin e ujësjetës dhe ujërave të ndotura).

2.5.4 Efikasitet i stafit

Efijenca e stafit në KRU-të gjatë vitit 2022, është pasqyruar përmes treguesit në vijim, i cili pra tregon numrin e punonjësve (stafit) të rregullt të angazhuar në shërbime të ujësjetës dhe të ujërave të ndotura, për të ju shërbyer 1000 konsumatorëve. Ky është tregues standard i performancës ose efikasitetit të menaxhimit. Sa më të ulëta të jenë shifrat aq më i lartë është efikasiteti menaxhues.




Figura - 21 Efikasiteti i stafit

Në vitin 2022 në raport me vitin 2021, efikasiteti i stafit në nivel të sektorit është përmirësuar pak, duke rënë në normën 4.59 nga 4.84 sa ishte në vitin 2021, rezultat i të cilës ka qenë rritja e konsiderueshme e numrit të konsumatorëve (kryesisht brenda zonave ekzistuese të shtrirjes së shërbimeve).

Shtatë (7) KRU në Kosovë ofrojnë një raport mesatar prej 4.59 për lidhjet staf/000', përndryshe, indeksi i efikasitetit të stafit në KRU 'Gjakova' 6.22, 'Hidroregjioni Jugor' 5.75, 'Mitrovica' 5.60 dhe 'Bifurkacioni' 5.38, është më i ultë në krahasim me ofruesit tjerë vendor. Kjo do të thotë se ata kanë një numër të madhe të të punësuarve për 1000 konsumatorë. Efikasiteti i stafit është më i lartë në KRU 'Prishtina' 3.41, 'Hidromorava' 4.18 dhe 'Hidrodrini' 4.35 të cilat kanë arritur ti tejkalojnë këto praktika.

Është shumë e rëndësishme të dihet se me çfarë efikasiteti i përdorin burimet njerëzore secila kompani, edhe pse nuk ka një standard të përcaktuar për numrin e të punësuarve për 1000 konsumatorë, bazuar në praktikën e mira ndërkombëtare rekomandohet të ketë maksimum 5 punëtor për 1000 konsumatorë për të pasur efikasitet të mirë të stafit. Përndryshe vendet e Evropës

perëndimore gjegjësisht në grupin aktual EBC, efikasiteti i stafit variron nga 0,29 në 6,41 staf/1000 konsumatorë apo me një mesatare për 0,83 staf/1000 kons.⁸, për shërbime të ujit.

Tabela - 14 Efikasiteti i realizuar dhe ai i planifikuar për vitet 2021 dhe 2022

Efikasiteti i stafit	Realizimi	Planifikimi
KRU	2022	2022
PR	3.41	3.46
PZ	5.75	6.74
PE	4.35	4.69
MIT	5.60	5.66
GJA	6.22	6.93
FE	5.38	6.70
GJI	4.18	4.31
Sektori	4.59	4.96

Kompanitë edhe në këtë tregues patën vendosur objektiva, të cilat janë përbushur nga të gjitha KRU.

⁸EBC-European Benchmarking Co-operation-Learning from International Best Practices-2021

3. PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË

ARRU është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të NPH Ibër Lepenci, e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU Mitrovica dhe KRU Prishtina.

Në vazhdim, në formë tabelore janë dhënë statistikat dhe disa tregues të performancës për trendet e zhvillimit të performancës në vitin 2022, në raport me vitin 2021.

Tabela - 15 Të dhënat statistikore për NHE 'Ibër-Lepenci'

Të dhënat statistikore për 2022 / 2021	2021	2022
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m3)	48,708,395	48,572,799
Faturimi për ujin me shumicë (€)	1,199,496	1,451,789
Arkëtimi për ujin me shumicë (€)	1,074,248	1,417,694
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	1,627,610	1,907,045
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	79	73

Në vitin 2022, shitjet e ujit në vlerë sasiore, kanë rënë për 0.3% krahasuar me vitin 2021. Përderisa te KRU 'Mitrovica', shitjet sasiore të ujit kanë rënë për rreth 2%, shitjet për KRU 'Prishtina' janë rritur po me të njëjtën normë. Faturimi për ujin me shumicë është rritur për vlerën 0.25 mil.€ apo për 21%, kryesisht i ndikuar nga ngritja tarifore në vitin 2022.

Shpenzimet operative për furnizimin e ujit me shumicë janë rritur për 0.275 mil.€ apo 17% në vitin 2022 në raport me vitin 2021.

Tabela - 16 Treguesit e Performancës së NHE 'Ibër-Lepenci'

Treguesi i performancës	2021	2022
Shkalla e arkëtimit	90%	98%
Norma e punës	0.74	0.76
Norma e mbulimit të punës	0.66	0.74
Kostoja e operimit për njësi (€/m3)	0.033	0.039

Në tabelën 16, është dhënë një pasqyrë e treguesve financiar në bazë të të cilëve mund të vlerësohet performanca e NPH 'Ibër Lepenci' gjatë vitit 2022/2021.

NPH Ibër Lepenci, ka arritur normën e shkallës së arkëtimit në nivel prej 98%, në vlerë monetare kjo është për 0.34 mil.€, apo 32%, për shkak të rritjes së vlerës monetare të faturimit.

Rritja e arkëtimit të hyrave përkundër rritjes së shpenzimeve të ujit ka ndikuar që norma e mbulimit të punës të jetë më e lartë gjatë vitit 2022 krahasuar me vitin 2021. Megjithatë kjo mbetet ende nën nivelin e dëshiruar për të mbuluar shpenzimet e krijuara gjatë vitit 2022, kryesisht për shkak të kostove të larta njësi 0.039 (€/m3)

SHTOJCA 1: Pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave

KRU Prishtina (Prishtinë)

	2021	2022
Qarkullimi	14,389,147	15,783,436
Shpenzimet operative	10,254,012	10,784,853
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	4,135,138	4,998,583
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukture + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	678,841	712,559
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	3,456,294	4,286,024
Provizionimi i borxheve të këqija	2,679,913	1,380,510
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	776,381	2,905,514
Kamata në huat afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	776,381	2,905,514
Tatimi në profit	0	0
Profiti neto pas tatimit	776,381	2,905,514

KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren)

	2021	2022
Qarkullimi	5,119,987	5,299,963
Shpenzimet operative	3,872,999	4,081,718
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	1,246,988	1,218,245
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukture + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	131,097	317,331
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	1,115,891	900,914
Provizionimi i borxheve të këqija	371,249	4,391
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	744,642	896,523
Kamata në huat afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	744,642	896,523
Tatimi në profit	0	0
Profiti neto pas tatimit	744,642	896,523

KRU Hidrodrini (Pejë)

	2021	2022
Qarkullimi	4,022,313	4,278,198
Shpenzimet operative	2,903,741	3,104,474
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	1,118,572	1,173,724
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	133,622	180,282
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	984,950	993,442
Provizionimi i borxheve të këqija	898,458	-1,260,211
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	86,492	2,253,653
Kamata në huat afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	86,492	2,253,653
Tatimi në profit	0	0
Profiti neto pas tatimit	86,492	2,253,653

KRU Mitrovica (Mitrovicë)

	2021	2022
Qarkullimi	4,604,978	4,768,640
Shpenzimet operative	3,363,491	3,635,502
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	1,241,487	1,133,138
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	24,819	30,968
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	1,216,668	1,102,170
Provizionimi i borxheve të këqija	1,354,452	1,120,609
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	-137,783	-18,439
Kamata në huat afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	-137,783	-18,439
Tatimi në profit	0	0
Profiti neto pas tatimit	-137,783	-18,439

KRU Gjakova (Gjakovë)

	2021	2022
Qarkullimi	4,687,018	4,427,671
Shpenzimet operative	3,642,510	3,901,794
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	1,044,508	525,877
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	366,332	391,253
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	678,176	134,624
Provizionimi i borxheve të këqija	233,430	-172,581
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	444,746	307,205
Kamata në huat afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	444,746	307,205
Tatimi në profit	0	0
Profiti neto pas tatimit	444,746	307,205

KRU Bifurkacioni (Ferizaj)

	2021	2022
Qarkullimi	2,213,838	2,449,715
Shpenzimet operative	1,517,168	1,579,546
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	696,670	870,169
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	31,454	35,497
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	665,216	834,672
Provizionimi i borxheve të këqija	654,146	489,860
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	11,070	344,812
Kamata në huat afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	11,070	344,812
Tatimi në profit	0	0
Profiti neto pas tatimit	11,070	344,812

KRU Hidromorava (Gjilan)

	2021	2022
Qarkullimi	2,284,171	2,323,811
Shpenzimet operative	1,784,596	1,785,009
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	499,575	538,802
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	42,751	51,533
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	456,824	487,269
Provizionimi i borxheve të këqija	332,216	201,578
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	124,608	285,691
Kamata në huat afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	124,608	285,691
Tatimi në profit	0	0
Profiti neto pas tatimit	124,608	285,691

SHTOJCA 2: PASQYRAT TARIFORE (2021-2022)

Pasqyra aktuale tarifore për vitin 2021

	Njësia	KRU Prishtina	KRU Hidroregioni i Jugor	KRU Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Gjakova	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava
Konsumatorët shtëpiak								
Tarifa fikse për Furnizimin me Ujë	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
Tarifa volumetrike për Furnizimin me Ujë	EUR/m ³	0.43	0.38	0.25	0.34	0.37	0.35	0.34
Tarifa për Ujëra të ndotura (bazuar në volumn e ujit të konsumuar)	EUR/m ³	0.05	0.14	0.07	0.09	0.07	0.10	0.08
Konsumatorët Komerical dhe Institucional								
Tarifa fikse për Furnizimin me Ujë	EUR/muaj	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00
Tarifa volumetrike për Furnizimin me Ujë	EUR/m ³	0.69	0.67	0.44	0.55	0.67	0.55	0.54
Tarifa për Ujëra të ndotura (bazuar në volumn e ujit të konsumuar)	EUR/m ³	0.11	0.32	0.15	0.20	0.16	0.23	0.17

Tarifat e aplikueshme për vitin 2022 (1 Janar - 31 Dhjetor 2022)

	Njësia	KRU Prishtina	KRU Hidroregjioni Ishëm	KRU Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Gjakova	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava
Konsumatorët shtëpiak								
Tarifa fikse për Furnizimin me Ujë	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
Tarifa volumetrike për Furnizimin me Ujë	EUR/m ³	0.44	0.38	0.25	0.36	0.37	0.37	0.35
Tarifa për Ujëra të ndotura (bazuar në volumin e ujit të konsumuar)	EUR/m ³	0.06	0.14	0.14	0.09	0.14	0.10	0.08
Konsumatorët Komercial dhe Institucional								
Tarifa fikse për Furnizimin me Ujë	EUR/muaj	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00
Tarifa volumetrike për Furnizimin me Ujë	EUR/m ³	0.67	0.57	0.37	0.54	0.56	0.55	0.52
Tarifa për Ujëra të ndotura (bazuar në volumin e ujit të konsumuar)	EUR/m ³	0.13	0.32	0.31	0.20	0.30	0.22	0.17

Tarifat e ujit të pa trajtuar për vitin 2021

KRU	Njësia tarifore	Viti 2021
Mitrovica	€/m ³	0.0163
Prishtina	€/m ³	0.0364

Tarifat e ujit të pa trajtuar për vitin 2022

KRU	Njësia tarifore	Viti 2022
Mitrovica	€/m ³	0.0201
Prishtina	€/m ³	0.0433

Tarifa volumetrike për aktivitete themelore të ofrimit të shërbimeve të ujit më shumicë

KRU	Njësia tarifore	Viti 2021	Viti 2022
Mitrovica	€/m ³	0.17	0.17